



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 786/2 prot.

Tepelenë, më 04.05.2026

V E N D I M

Nr. 30, datë 29.04.2026

PËR DHËNIE TITULL NDERI

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 29/04/2026, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54 pika “m”; Ligjit 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit të RSH” pasi shqyrtoi materialin e Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë,

V E N D O S I

A. Të miratojë dhënien e titujve të nderit si më poshtë:

- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” **Z. Sulejman Liçaj** (Pas vdekjes) me motivacionin *“Për kontributin e çmuar në hedhjen e themeleve të shkollës kombëtare shqiptare të muzikës profesioniste përmes përfshirjes në lëvizjen kulturore dhe artistike në përgjithësi, dhe asaj bandistike në veçanti, në qytetin e Shkodrës e në mbarë trevat shqiptare”.*
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” **Z. Ardian Hana** (Pas vdekjes) me motivacionin: *“Për sakrificën në krye të detyrës, përkushtimin e palëkundur ndaj shtetit dhe shoqërisë, si dhe për guximin, ndershmërinë dhe dashurinë për atdheun”.*

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social.

C. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI



Miratuar me 11 (njëmbëdhjetë) vota  
Vota Pro 11 (njëmbëdhjetë) vota  
Vota Kundër 0  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur më datë 04.05.2026